

Procesverbal

Konsultim publik : Takim me banorët e Bashkise Korçë

Data : 16.11.2021

Ora : 18.00

Vendi: Teatri “Andon Zako Cajupi”

Numri i pjesëmarrësve : totali _____; nga të cilët _____ gra dhe vajza, _____ burra (sipas listës bashkëlidhur)

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Paketa Fiskale 2022 dhe PBA 2022-2024, te Bashkise Korce

Pjesëmarrës : Janë prezent: Kryetari i Bashkisë z. Sotiraq Filo; Kryetari i Këshillit Erjon Nexhipi; Kryesia e Këshillit znj. Edlira Mitre, znj.Edlira Menkshi, z.Shkëlqim Kajmaku; Drejtuesit e Drejtorive të Bashkisë, znj.Zhaneta Lubonja, znj.Anxhela Dishnica, znj. Valbona Ziko, z.Illir Zguri, z. Soniel Prifti; Këshilltarë të Këshillit Bashkiak; qytetarë; pjesëtarë të shoqërisë civile dhe grupe të interesit.

Takimi drejtohet nga Kryetari i Keshillit bashkiak Z. Erjon Nexhip, i cili hapi takimin duke u ndalur ne:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Ne fjalën e tij ne lidhje me draft Paketën fiskale 2022 te bashkise Korce, Kryetari i Bashkise Z. Sotiraq Filo u ndal ne sa me poshte:

- ✦ Ky takim është një takim në vazhden e shumë takimeve konsultuese që Bashkia e Korçës ka realizuar në qytet dhe në të gjitha Njësitë Administrative, ku ne i kemi folur dhe diskutuar këto çështje, megjithatë i diskutojmë edhe njëherë në këtë takim të organizuar nga Këshilli Bashkiak.
- ✦ Ne paketën fiskale, ndryshimet kryesore që reflektohen mbështeten tek kërkesat dhe vërejtjet që janë marrë nga banorët, apo nga gjëra që janë reflektuar nga vetë Bashkia.
- ✦ Sigurisht që paketa ka një trend lehtësues për disa kategori familjesh si për shembull kryefamiljari që trajtohet me ndihmë ekonomike përjashtohet nga tarifatat vendore;

- ✦ familjet me një anëtar pensionist të vetmuar iu përgjysmohet ngarkesa fiskale;
- ✦ për banoret në njësitë administrative, për pastrimin e kanaleve kullues dhe pastrimin në përgjithësi do të aplikohet një tarifë vetëm për atë përqindje të tokës, e cila ndodhet në një zonë ku mund të shërbehet;
- ✦ ka ulje të tarifave për ata që ofrojnë shërbimin taxi;
- ✦ shfuqizohet tarifa e therrjeve të bagëtive;
- ✦ kemi ndryshime në riformulimin e tarifës të zënies së hapësirës publike;
- ✦ shfuqizim i mbështetjes financiare të Bashkisë për BID dhe TID për shkak të ndryshimeve në organizimin e këtyre shoqatave;
- ✦ kemi saktësim të taksës të aplikimit në infrastrukturë, për ndërtim;
- ✦ kemi miratim të nivelit të çmimit të biletave për Klubin Shumësportësh;
- ✦ ndryshime në nivelet e gjobave nga ana e kontrollit të territorit;
- ✦ masa lehtësuese për të mbështetur bizneset e reja, siç janë bizneset e studentëve ku mendohet një tarifë 0 për vitin e parë të aplikimit
- ✦ masa lehtësuese për hotelerinë në zonat turistike konkretisht në fshatrat e Voskopojës, Dardhës dhe Boboshticës.
- ✦ Ka vend për masa edhe më lehtësuese, por në përshtatje gjithmonë me kushtet.

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Z. Erjon Nexhipi, Kryetari i KB, sjell shqetesimin e nje numri te konsiderueshem banoresh qe konsiston ne: Situaten e banorëve të larguar nga qyteti apo njësitë administrative, të cilët kanë qënë të tarifuar gjatë gjithë asaj kohe që kanë qënë të larguar dhe tani u janë faturuar të gjitha tarifatat sëbashku në shumën të konsiderueshme lekësh, 400-500 mijë lekë të vjetra dhe sigurisht që kjo i rëndon. Ky është një problem që unë e kam përmendur edhe në mbledhjet tona të Këshillit, pyes nëse ka parashikuar kjo paketë diçka për ta? Ndërsa për familje që jetojnë jashtë shtetit, emigrantët përfitojnë nga falje apo përgjysmime të tarifave edhe pse kur vijnë në periudhë pushimesh përfitojnë nga të gjitha shërbimet e institucioneve.

Znj. Shkelqim Kajmakure rekomandon se; se një lloj tarife të paktën ata që jetojnë jashtë duhet ta paguajnë.

Z. Perfaqesues nga publiku: rekomandon se; Pensionistët e vetmuar duhet të jenë më të lehtësuar nga taksat sesa lehtësimi i emigrantëve, sepse në fund të fundit një emigrant nuk i kushton asgjë nga të ardhurat e tij, për të paguar një shumë të caktuar në fund të vitit në krahasim më të moshuarit që jetojnë vetëm.

Znj. Edlira Mekshi keshilltare, sjell nevojën për adresim për rastin e një qytetareje të Bilishtit, e cila është transferuar bashkë me fëmijët e saj në qytetin tonë dhe më ka pyetur vazhdimisht mbi

mundësitë e strehimit që ajo mund të përfitojë në qytetin e Korçës, meqënëse edhe vendbanimin e ka kaluar në Korçë.

Perfaqesues nga OJF; rekomandonte kete nje buxhet te percaktuar per rinine ne buxhetin e bashkise.

Perfaqesues nga publiku; Kerkon informacion ne lidhje me situaten e shoqatave BID dhe TID, ne raport me paketen fiskale dhe mbeshtetjen nga bashkia.

Këshilltari I.Nikaj; Shprehet që në punën dhe projektin që do të shfaqet për buxhetin, të dalë më në pah puna e Bashkisë në kuadrin e barazisë gjinore, të jetë një zë i veçantë, i shkruar, buxheti i barazisë gjinore në mënyrë që të përmendet dhe të promovohet siç duhet.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi; konfirmon dhe rekomandon se duhet të shkruhet tek dokumenti narrativ i buxhetit në lidhje me “barazinë gjinore”

Përfaqësues të Shoq.Civile; Për paktën fiskale nuk kemi gjë, vetëm për diçka në tarifën e OJF-ve që përfshihen tek buxheti kemi. Për OJF-të e vogla, tarifën momentalisht janë të papërbalueshme.

Këshilltari E.Menkshi; Rekomandon që tarifa e parkimit për zonat rezidente të aplikohet edhe tek zona të tjera. Tek zona Trekëndëshi, situata e parkimit është vërtetë shqetësuese dhe nuk kemi pse të grindemi dhe diskutojmë çdo ditë për parkimin, kur shumë mirë mund të paguajmë edhe në atë tarifë që duhet dhe të funksionojë çdo gjë në rregull.

Këshilltari A.Verushi; Po flitet për të njëjtën zonë ku banoj edhe unë, është e vërtetë që kemi probleme me parkimin, është zonë e vështirë ku duhet të ndërhyhet.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi; Shprehet dakord dhe rekomandon se duhet menduar një plan i menaxhimit të trafikut në qytet, e kemi diskutuar disa herë edhe në mbledhjet e Këshillit, duhet menduar për një studim të mirëfilltë të situatës së trafikut në qytet.

Publiku; Rekomandon për një rishikim të tarifave për fëmijët tek Qyteza e Fëmijëve, ulje të tarifave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi; Për pjesën e buxhetit megjithëse është në punim e sipër mund të thotë diçka më tepër Kryetari. Me ato vendime që ne si Këshill kemi miratuar deri tani mund të themi se buxheti është në rritje tani, pas goditjes së vitit të kaluar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo; Nuk jemi gati akoma për të folur për buxhetin, por mund të themi se përveç përmirësimeve dhe rritjeve në grupin e shërbimeve operative, flitet për investime me prioritet të percaktuar sidomos për njësitë administrative, ku infrastruktura e fshatrave që janë në gjendje jo të mirë kërkon projekte të mirëfillta, por patjetër që përqëndrimi do të jetë edhe në përmbyllje të projekteve brenda qytetit. Unë gjithashtu kam percaktuar si prioritet zgjidhjen e një alternative për ngrohjen në qytet, do të jetë një prioritet i punës së Bashkisë, megjithëse nuk ka një buxhet të mirëfilltë për këtë gjë, por po punojmë për projektet njëherë, pastaj të marrim donatorët. Patjetër një fokus të veçantë ka gjithmonë turizimi dhe zhvillimi i tij, por edhe programet e zhvillimit të teknologjisë dhe informacionit janë shumë të rëndësishme si një

mundësi shumë e mirë për të rinjtë për të cilat jemi duke lobuar me donatorë të ndryshëm për këto programe. Vëmendje në qytetin tonë do të kenë gjithmonë edhe arti, kultura, arsimi dhe sporti patjetër. Ndërkohë edhe skemat sociale nuk mund të lihen pas, pavarësisht fokusit të buxhetit tonë të përcaktuar, do të kenë edhe ato vëmendjen e tyre. Defiçitor jemi vetëm tek mundësitë e punesimit, kjo është sfida më e madhe.

Publiku: Kerkon informacion ne lidhje me një projekt mbi ngrohjen e shkollave të mesme në qytet nëpërmjet energjisë, deri ku qëndron ky projekt?

Këshilltare L.Nikaj: rekomandon ne emer te Aleances se Zgjeruar te Keshilltareve disa nisma: -Titulli Gruaja e Vitit në disa fusha të caktuara. - Pajisja me psikologë dhe punonjës social për arsimin parashkollor.

Publiku, përfaqësuese e shkollës të fshatit Bulgarec; Shprehet se kane organizuar edhe një peticion, mbi nevojen per sistemimin dhe rregullimin e strukturave të infrastrukturës të shkollës pasi gjendet në gjendje vërtet shqetësuese.

Këshilltare E.Mitre: Ka edhe kërkesa për shtimin e çerdheve nga ana e prindërve, sepse kanë probleme ku t'i lenë fëmijët e vegjël.

Publiku: Jam banor i lagjes 4, kemi disa rruge problematike që nuk u prekën kur u rregulluar rruga kryesore dhe at tani janë bërë shqetësuese për banorët. Kerkojme te rregullohen.

Sekretari i Këshillit

EVA NAÇI